

## Shkrim akademik

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Shkrim akademik
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	viti i II-të, semestri i IV-t
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit të shpallur
Mësimdhënësi:	Prof.asoc.dr. Sadije Rexhepi
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:sadije.rexhepi@uni-pr.edu">sadije.rexhepi@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	<p>Në këtë lëndë studentët do të mësojnë dhe do të ushtrorjnë procesin dhe mënyrat e realizimit të shkrimit akademik, do të mësojnë të shkruajnë lloje të ndryshme të teksteve që iu nevojiten gjatë studimeve, si exposé, protokol, ese, seminar.</p> <p>Mënyra për të shkruar qartë dhe saktë është njëra ndër kushtet e domosdoshme që duhet mësuar. Secili student ka mundësi që përmes ligjëratave dhe ushtrimeve të mësojë të shkruajë drejt, t'i mësojë hapat e hulumtimit dhe të organizimit të një punimi, të mësojë për proceset e të shkruarit të një punimi, llojet e shkrimeve gjatë studimeve, në përgjithësi të krijojë një përvojë në të shkruar.</p> <p>Të shkruarit e çfarëdo lloj shkrimi nënkupton aftësi themelore të të shkruarit, njohuri të zbatimit të gramatikës si dhe një fjalor të pasur individual në mënyrë që të realizojmë fjali dhe njësi të tjera themelore të një shkrimi të tillë. Pra, studenti gjatë ushtrimeve do të ushtrorjë të shkruarit e një teksti, ai duhet të pasurohet me fjalë të duhura të nivelit akademik, të zgjedhë fjalitë e duhura, t'i radhisë ato në mënyrë të drejtë, të bëjë ndarjen e paragrafeve, të argumentojë një tekst, të përdoren në mënyrë të rregullt citatat, burimet dhe fusnotat.</p>
Qëllimet e lëndës:	Gjatë orëve që do të mbahen në kuadër të kësaj lënde mësimore studentët do të kenë mundësi të shkruajnë punime të ndryshme individuale dhe në grupe. Këtu duhet cekur se eseu, një seminari apo një punim i çfarëdoshëm akademik, që konsiderohet të jetë prodhim final i një veprimtarie me rregulla teorike dhe ushtrime praktike të po atyre rregullave, është rezultat i përpjekjeve të shumta të mësuar mirë

gjatë nxënies së procesit të të shkruarit akademik dhe njëherit është edhe qëllimi i këtij kursi.

**Rezultatet e pritshme të nxënies:**

- Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:
- të përvetësojë njohuri dhe aftësi të mjaftueshme për të shkruar në mënyrë akademike,
- të kuptojë konceptet themelore të hulumtimit
- t’i mësojë fazat e rëndësishme të një hulumtimi
- të mund ta organizojë hulumtimin,
- të mësojë llojet e ndryshme të teksteve,
- të ushtrojë aftësinë e të menduarit të arsyeshëm,
- të dijë ta vendosë tezën brenda një teksti (eseu),
- të dijë të argumentojë,
- të mbështesë një qëndrim në mënyrë logjike, të rregullt dhe koherente
- të dijë ta ndajë tekstin në pjesët përbërëse,
- të mbështesë një qëndrim në mënyrë logjike, të rregullt dhe koherente,
- të realizojë një diskutim retorik gjatë procesit të të shkruarit,
- të dijë si t’i sistemojë idetë dhe fragmentet e huazuara të tekstit sipas sistemeve ndërkombëtare të të cituarit,
- të përdorë me sukses gjuhën e shkruar letrare,
- të njihet për së afërmi me realizimin e një prezantimi

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	1	15	15
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	15 min.	15	4
Puna në terren			

Testi, punimi i seminarit	20	2	40
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja për provimin final	5	2	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	1	2
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
<b>Total</b>			<b>109.5 orë: 25=5.16 5 ECTS</b>

<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	Mësimi do të mbahet në formë të kombinuar nëpërmjet ligjëratave dhe ushtrimeve, do të punohet në mënyrë individuale, në çifte, dhe në grupe, ndërsa gjatë tërë semestrit studentët do të vlerësohen për rezultatet e punës së tyre. Prezantimet dhe diskutimet e studentëve rreth temave të ndryshme që do t'i zgjedhim, do të përbëjnë thelbin e punës së tyre. Këto prezantime së bashku me punimet me shkrim që do të realizohet gjatë kursit, do të jenë dëshmia më e mirë e përvetësimit të suksesshëm të lëndës së shkrimit akademik.
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%. Vijueshmëria e studentit dhe angazhimi 10%; Exposé 20%; Seminari 60% Prezantimi i seminarit 10%.
<b>Literatura primare:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Eco, Umberto. 2020. <i>Wie man eine wissenschaftliche Abschlussarbeit schreibt</i>. Heidelberg.</li> <li>2. Pospiech, Ulrike. 2017. <i>Wie schreibt man wissenschaftliche Arbeiten?</i> Duden-Ratgeber. Berlin.</li> <li>3. Hahn, Sophie. 2021. <i>Wissenschaftliches Arbeiten: So wird Ihre Bachelor- oder Masterarbeit und jede andere Wissenschaftliche Arbeit zu einem Meisterwerk</i>. PLK Verlag.</li> <li>4. Gruber / Huemer / Rheindorf. 2009. <i>Wissenschaftliches Schreiben. Ein Praxisbuch für Studierende</i>. Weimar.</li> <li>5. Kornmeier, Martin. 2008. <i>Wissenschaftlich Schreiben leicht gemacht - für Bachelor, Master und Dissertation</i>, Bern.</li> <li>6. Grätz, Frank. 2006. Duden. <i>Wie verfasst man wissenschaftliche Arbeiten?: Ein Leitfaden für das Studium und die Promotion</i>. Dudenverlag, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich.</li> <li>7. Balzert/Schröder/ Schäfer. 2012. <i>Wissenschaftliches Arbeiten</i>, Wilhelm Büchner Hochschule, Darmstadt.</li> <li>8. Rothstein, Björn. 2011. <i>Wissenschaftliches Arbeiten für Linguisten</i>, Narr Verlag, Tübingen.</li> </ol>

	<p>9. Esselborn- Krumbiegel, Helga. 2010. <i>Richtig wissenschaftlich schreiben. Wissenschaftssprache in Regeln und Übungen</i>, UTB, Stuttgart.</p> <p>10. Bünting, Karl-Dieter; Bitterlich, Axel; Postpiech, Ulrike. 2000. <i>Schreiben im Studium mit Erfolg, Ein Leitfaden</i>, Berlin.</p> <p>11. Esselborn- Krumbiegel, Helga. 2010. <i>Richtig wissenschaftlich schreiben. Wissenschaftssprache in Regeln und Übungen</i>, UTB, Stuttgart.</p>
Literatura shtesë:	<p>1. Karmasin, Mathias, Ribing, Rainer. 2010. <i>Die Gestaltung wissenschaftlicher Arbeiten: Ein Leitfaden für Seminararbeiten</i>, Stuttgart.</p> <p>2. Trapp, Sebastian. 2007. <i>Wie man tatsächlich eine wissenschaftliche Arbeit schreibt: Daten, Schreibtechnik, Zeitplanung, Veröffentlichung - in der realen Welt</i>.</p>

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Prezantimi i silabusit
Java 2:	Çka është punimi shkencor Procesi i të shkruarit – parashkrimi dhe planifikimi
Java 3:	Etapat e hulumtimit për një punim shkencor
Java 4:	Llojet e teksteve të punimeve (të shkruara) gjatë studimeve
Java 5:	Expose
Java 6:	Eseu, struktura dhe rëndësia e paragrafeve brenda eseut
Java 7:	Koherenca; Tipat e rrjedhës logjike të fjalive
Java 8:	Argumentimi
Java 9:	Seminari, struktura dhe mënyrat e organizimit të seminarit
Java 10:	Strategjitë dhe metodat e hulumtimit
Java 11:	Citimet, dokumentimi i burimeve dhe shenjat e korigjimit
Java 12:	Analiza praktike e korpusit
Java 13:	Redaktimi
Java 14:	Prezantimi i seminareve
Java 15:	Prezantimi i seminareve

**Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

*Për të fituar të drejtën për të hyrë në teste dhe provim, studentët janë të obliguar t'i vijnë ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave*

*disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet e tjera elektronike duhet të fikën (apo të jenë pa zë) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.*